



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____. _____. 20____

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 426, DATË 9.7.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRBALLIMIN NGA SHTETI TË SHPENZIMEVE TË SHËRBIMIT TË VARRIMIT PËR SHTETASIT SHQIPTARË QË VDESIN BREnda DHE JASHTË SHTETIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.426, datë 09.07.2018 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Njësitë e qeverisjes vendore, me fonde të Buxhetit të Shtetit, mbulojnë shpenzimet e transportit të kufomave dhe të eshtrave vetëm për rastet e fatkeqësive të ndodhura jashtë territorit të vendit, për personat që janë dërguar me shërbim ose mjekim shëndetësor nga shteti, për punonjësit e përfaqësive diplomatike, si dhe për rastet e veçanta, sipas kërkesës së bërë nga institucione apo shoqata të ndryshme.

Për shtetasit shqiptarë, që vdesin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur shpenzimet e transportit përballohen nga familjarët e të ndjerit, njësitë e qeverisjes vendore me fonde të Buxhetit të Shtetit, rimburojnë një pjesë të këtyre shpenzimeve.

Rastet e veçanta dhe masa e kontributit të shtetit në përballimin e shpenzimeve të varrimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë."

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Damian Gjilknuri

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 426, DATË 9.7.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRBALLIMIN NGA SHTETI TË SHPENZIMEVE TË SHËRBIMIT TË VARRIMIT PËR SHTETASIT SHQIPTARË QË VDESIN BRENDA DHE JASHTË SHTETIT", TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 426, Datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave, "Për Përballimin nga Shteti të Shpenzimeve të Shërbimit të Varrimit për Shtetasit Shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë Shtetit", të ndryshuar", parashikon kryerjen e rimbursimit të shpenzimeve të transportit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe jo më nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke sjellë kështu reduktim të kohës dhe shpenzimeve të qytetarëve, si dhe përmirësim të cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj tyre.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim nuk është parashikuar në programin analitik të akteve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Bazuar në VKM-në Nr. 426, date 9.7.1998 "Për përballimin nga shteti të

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 426, Datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit", të ndryshuar".

shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit” të ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrit përgjegjës për financat Nr. 3912, datë 21.06.2004 “Mbi procedurat për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin brenda dhe jashtë shtetit”, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) është institucioni përgjegjës për organizimin e shërbimit të transportit të kufomave dhe të eshtrave vetëm për rastet e fatkeqsive të ndodhura jashtë territorit të vendit, për personat që janë dërguar me shërbim ose mjekim shëndetësor nga shteti, për punonjësit e përfaqësive diplomatike, si dhe për rastet e veçanta, sipas kërkesës së bërë nga institucione, njësi të qeverisjes vendore apo shoqata të ndryshme.

Gjithashtu, për shtetasit shqiptarë që vdesin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur shpenzimet e transportit përballohen nga familjarët e të ndjerit, Buxheti i Shtetit rimbursion një pjesë të këtyre shpenzimeve nëpërmjet MIE-s.

Aktualisht, MIE vetëm rimbursion një pjesë të shpenzimeve të transportit për të gjithë subjektet e përcaktuar në VKM-në nr. 426, date 9.7.1998 “Për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit”, të ndryshuar.

Mbështetur në VKM-në 426, ky detyrim ligjorë i MIE, mbulohet nga Sektori i Financës në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, duke filluar që nga dorëzimi i dokumentave nga familjarët, kontrolli i dokumentacionit, si dhe kryerja e udhër shpenzimeve në degën e thesarit.

Fluksi mesatar mujor për rimbursimin e shpenzimeve arrin rreth 250 – 300 persona në muaj.

Ndërkohë që, MIE vetëm për vitin 2018, për rimbursimin e shpenzimeve të varrimit ka planifikuar në buxhetin e shpenzimeve korrente, fondin me vlerë 70 milion lekë.

Në lidhje me këtë detyrim ligjor të MIE është shprehur edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit në “Raportin Perfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”, të dërguar me shkresën nr. 1189/13, datë 28.04.2017, i cili në pikën 9 të tij rekomandon:

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 426, Datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit”, të ndryshuar”.

“MIE, për të lehtësuar personat përfitues për rimbursimin e shpenzimeve të varrimit për shtetasit shqiptar që humbin jetën jashtë vendit, është e nevojshme të bëjë një zgjidhje fundore të tyre. Për këtë qëllim, t’i kërkojë/propozojë Këshillit të Ministrave kalimin e kompetencave në lidhje me këtë shpenzim njësisive të qeverisjes vendore, si një mënyrë jo vetëm për reduktimin e riskut të rimbursimit dy herë të të njëjtit përfitues, por njëkohësisht dhe lehtësimin e përfituesve për këtë shërbim”.

Duke patur parasysh sa më sipër, fluksin mesatar mujor të qytetarëve që paraqiten pranë MIE-s për rimbursimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit që vdesin jashtë shtetit, kostot e transportit nga Njësia e Qeverisjes Vendore ku banon qytetari deri në Tiranë, të tilla si: biletë autobuzi, shpenzime karburanti, shpenzime personale deri në Tiranë, si dhe rekomandimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, propozojmë ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 426, datë 9.7.1998 “Për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit”, të ndryshuar, me qëllim kalimin e kësaj kompetence tek Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Kalimi i kësaj kompetence, për rimbursimin e shpenzimeve të varrimit tek Njësitë e Qeverisjes Vendore, do të sjellë reduktim të kohës, të shpenzimeve, si dhe përmirësim të cilësisë së ofrimit të shërbimit ndaj qytetarëve

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe ligjin nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në pikën 1, të projektvendimit parashikohet që, pika 3 e VKM-së Nr. 426, Datë 9.7.1998, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë,

“3. Njësitë e qeverisjes vendore, me fonde të Buxhetit të Shtetit, mbulojnë shpenzimet e transportit të kufomave dhe të eshtrave vetëm për rastet e fatkeqësive të ndodhura jashtë territorit të vendit, për personat që janë dërguar me shërbim ose mjekim shëndetësor nga shteti, për punonjësit e përfaqësive diplomatike, si dhe për rastet e veçanta, sipas kërkesës së bërë nga institucione apo shoqata të ndryshme.

Për shtetasit shqiptarë, që vdesin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur shpenzimet e transportit përballohen nga familjarët e të ndjerit, njësitë e qeverisjes vendore me fonde të Buxhetit të Shtetit, rimbursojnë një pjesë të këtyre shpenzimeve.

Rastet e veçanta dhe masa e kontributit të shtetit në përballimin e shpenzimeve të varrimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë.”

Në pikën 2 parashikohet që, ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Së fundi, parashikohet që, ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe njësitë e qeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 426, Datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit”, të ndryshuar”.

Projektvendimi është hartuar nga strukturat e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare përballohen nga buxheti i bashkive.

MINISTRI

Damian GJIKNURI